

VENDIM
Nr.734, datë 1.7.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS BUBULLIMË TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Bubullimë të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bubullimë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Bubullimë
nr.1

Lidhja

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
13-19	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore sportive.	Në pronësi
20-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
27-29;31-27	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës.	Në pronësi
48-55	Shërbim funeral	Në pronësi
19,20	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
30,207	Prona që përdoren në- fushën e infrastrukturës (troje).	Në përdorim
56-96	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
210-212,215-229	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, trotuar)	Në pronësi
208,209	Furnizim me ujë të pijshëm	Në pronësi
108,131,142,152,161,173, 190,191,206	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive kanale të treta).	Në pronësi
97,98,99,100,105	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim